



**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MISIONI NË KOSOVË**

Bashkëpunimi i Kuvendit të Kosovës me shoqërinë civile

Mars, 2013

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	1
1. HYRJE	2
2. STANDARDET DHE PRAKTIKAT E MIRA – BASHKËPUNIMI MIDIS PARLAMENTIT DHE SHOQËRISË CIVILE	4
3. KUVENDI I KOSOVËS – ZBATIMI I STANDARDEVE DHE PRAKTIKAVE MË TË MIRA NË BASHKËPUNIMIN MES PARLAMENTIT DHE SHOQËRISË CIVILE	9
4. PËRFUNDIME	16
5. REKOMANDIMET PËR KUVENDIN:	18
SHTOJCA I: Pyetësor	20
SHTOJCA II: Lista e të intervistuarve.....	21

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Viteve të fundit, Kuvendi i Kosovës (Kuvendi) e ka shtuar kontributin e tij në politikat publike në Kosovë. Janë zgjeruar aktivitetet përkitazi me shqyrtimin e projektligjeve për të përfshirë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe, më së fundmi, nismat për hartimin e legjislacionit. Roli i zgjeruar i Kuvendit shton rëndësinë e transparencës dhe të qenurit të hapur ndaj pjesëmarrjes së publikut. Ky raport vështron mundësitë për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në punën e Kuvendit. Ai përqendrohet në tri tema: informacionin e nxjerrë nga Kuvendi për publikun, rregullimet institucionale në Kuvend për marrëdhëniet me shoqërinë civile, dhe praktikën e konsultimit publik. Ai e vlerëson punën e Kuvendit kundrejt standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira.

Në vitin 2012, Kuvendi ka marrë nismën për të krijuar struktura formale për marrëdhëniet me shoqërinë civile. Ai ka miratuar një Strategji gjithëpërfshirëse për informim dhe marrëdhënie me publikun, që do të përmirësojë informacionet në dispozicion për pjesëmarrjen e publikut në punën e tij. Kuvendi është në proces të ngritjes së një strukture gjithëpërfshirëse institucionale, përfshirë një regjistër të shoqërisë civile (bazë e të dhënave në internet) dhe një portofol të marrëdhënieve me shoqërinë civile në zyrën e Sekretarit të Kuvendit. Përveç konsultimeve ekzistuese të rregullta në kuadër të punës së tij legjislative dhe mbikëqyrëse, Kuvendi është përkushtuar që me shoqërinë civile të angazhohet në një dialog gjithëpërfshirës.

Ky raport i përshëndetë këto arritje të rëndësishme dhe identifikon sfidat kryesore. Sidoqoftë, informatat e nxjerra nga Kuvendi për publikun mbeten të pamjaftueshme. Kuvendi duhet t'i botojë rregullisht të gjitha dokumentet e punës në kohë dhe mënyrë të qasshme. Zbatimi i Strategjisë së Kuvendit për informim dhe marrëdhënie me publikun do ta adresonte në masë të madhe këtë mungesë.

Pasi të jenë futur rregullimet institucionale të Kuvendit për marrëdhëniet me shoqërinë civile janë adekuate, Kuvendi duhet të fillojë monitorimin e brendshëm të pjesëmarrjes së publikut në punën komisionet e Kuvendit në mënyrë gjithëpërfshirëse, për të vlerësuar fushëveprimin dhe cilësinë e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në proceset legjislative dhe mbikëqyrëse të Kuvendit. Gjithashtu, kjo do t'i mundësojë Kuvendit planifikimin e duhur të aktiviteteve të komunikimit. Fushëveprimi në rritje i ndërveprimit të Kuvendit me shoqërinë civile kërkon një përkufizim gjithëpërfshirës të kësaj marrëdhënieje në nivel të Kryesisë së Kuvendit.

Praktika e konsultimit të gjerë e Kuvendit në punën e tij legjislative dhe mbikëqyrëse është për t'u lavdëruar. Sidoqoftë, praktikën e konsultimit duhet të rriten më tej për të qenë në pajtueshmëri me praktikën e mira ndërkombëtare. Prandaj, për ta rritur transparencën do të mund të shtoheshin informacionet që u ofrohen palëve konsultuese. Komisionet duhet të bëjnë përpjekje që t'i lajmërojnë dëgjimet në kohë dhe t'i publikojnë transkriptet e plota dhe dëshmitë me shkrim si dhe t'ju ofrojnë informacion kthyes palëve konsultuese përkitazi me atë se a është marrë parasysh kontributi i tyre në procesin e vendimmarrjes apo jo.

Për t'i adresuar këto sfida do të jetë e nevojshme që Kuvendi të ndajë burime buxhetore dhe njerëzore për aktivitete të reja. Këto përgjegjësi të reja duhet të bien nën mbikëqyrjen e postit të

ri të zyrtarit të lartë për marrëdhënie me shoqërinë civile dhe personelit mbështetës të komisioneve.

1. HYRJE

Gjatë dekadës së fundit, ka pasur një njohje të rëndësishme në rritje të bashkëpunimit mes institucioneve demokratike dhe publikut. Disponueshmëria e përmirësuar e informacionit për publikun ka shtyrë institucionet qeverisëse që në proceset e bërjes së politikave të konsultohen gjithëherë e më shumë me anëtarët e publikut. Kjo praktikë e demokracisë pjesëmarrëse ka përparësi të rëndësishme krahas modelit reduksionist në demokracinë përfaqësuese, ku institucionet janë të mbrojtura nga pjesëmarrja e publikut në mes të zgjedhjeve: "Ajo krijon një kornizë për qytetarët që të avokojnë për interesat e tyre legjitime dhe, si rrjedhim, kontribuon në zhvillimin e një shoqërie demokratike plot gjallëri ..., [ajo] e bën punën e autoriteteve publike më transparente dhe më të afërt me votuesit e tyre ... [dhe] kontribuon në cilësinë e politikave publike të miratuara dhe zbatimin e lehtë të tyre."¹ Si rezultat, qeveritë dhe parlamentet në shumë vende të Evropës kanë miratuar mekanizma për pjesëmarrjen e publikut, shumica e të cilëve synojnë përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në procesin legjislativ.² Në rajonin e Ballkanit Perëndimor, këta hapa janë inkurajuar përmes proceseve të stabilizim-asocimit të Bashkimit Evropian.³

Parlamentet po e kuptojnë gjithnjë e më shumë se përfshirja e nevojave të publikut duhet të lëvizë përtej komunikimit me ekspertë të politikave në çështjet legjislative, drejt një kuadri më gjithëpërfshirës të bashkëpunimit dhe konsultimeve. Një shembull i praktikës së mirë është Parlamenti letonez. Në rajonin e Ballkanit Perëndimor, Parlamenti i Malit të Zi i ka bërë hapat e parë drejt një kuadri gjithëpërfshirës të këtillë. Të dyja parlamentet janë relativisht të reja, njëdhomëshe, të krahasueshme në madhësi dhe me kompetenca të ngjashme me ato të Kuvendit të Kosovës. Parlamenti letonez përfaqëson një legjislaturë të avancuar të një vendi anëtar të BE-së, ndërsa Parlamenti i Malit të Zi një legjislaturë të re nga rajoni i Ballkanit Perëndimor.

Gjatë disa viteve të fundit, Kuvendi i Kosovës e ka zgjeruar bashkëpunimin e tij me shoqërinë civile dhe ka bërë përmirësime të rëndësishme në infrastrukturën gjegjëse institucionale. Megjithatë, raportet e fundit kanë vënë në dukje sfida të vazhdueshme në zhvillimin e bashkëpunimit të tij me shoqërinë civile.⁴

Ky raport analizon në mënyrë gjithëpërfshirëse pjesëmarrjen e shoqërisë civile në punën e Kuvendit. Ai mbledh praktikatat më të mira nga parlamentet në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe pjesën tjetër të Evropës mbi tri aspekte të pjesëmarrjes së publikut: ofrimi nga ana e legjislativit i

¹ Dragan Goluboviq, "Kuadri mundësues për pjesëmarrjen e qytetarëve në politika publike: Përvijim i disa prej çështjeve kryesore në fjalë", *International Journal of Not-for-Profit Law* 12/14, nëntor 2010, f. 30-40.

² Shih Fondacionin Kosovar për Shoqëri Civile, *Pjesëmarrja qytetare: Praktikatat më të mira në Ballkanin Perëndimor dhe Bashkimin Evropian*, Prishtinë, tetor 2011.

³ *Zhvillimi dhe pjesëmarrja e shoqërisë civile në bërjen e politikave është identifikuar si fushë e asistencës së BE-së në dokumentin bazë të procesit të stabilizim-asocimit, Komisioni Evropian, Komunikatë nga Komisioni për Këshillin dhe Parlamentin Evropian mbi procesin e stabilizim-asocimit për vendet e Evropës Jugperëndimore*, COM(1999)235, 26 maj 1999.

⁴ *Po aty*, f.7.

informacioneve që kërkojnë veprim për publikun, ekzistenca e mekanizmave institucionale për lehtësimin e pjesëmarrjes së shoqërisë civile, si dhe aplikimi i praktikave të shëndosha të konsultimit publik. Ai vazhdon duke e vlerësuar performancën e Kuvendit kundrejt këtyre praktikave.

Gjetjet e këtij raporti bazohen si në të dhëna parësore ashtu edhe dytësore. Praktikave të përparuara janë nxjerrë nga dokumentet udhëzuese ndërkombëtare⁵ si dhe hulumtimet për parlamentet që aplikojnë praktika të tilla, në radhë të parë Parlamentin e Letonisë. Të dhënat mbi punën e Kuvendit janë nxjerrë nga raportet e mëparshme vlerësuese, të dhënat e Kuvendit të Kosovës dhe intervistat me palët e interesit. Intervistat janë kryer në periudhën ndërmjet majit dhe qershorit 2012 me tetë anëtarë të Kuvendit (anëtarë të Kryesisë së Kuvendit dhe personalitetet kryesore të komisioneve të Kuvendit); dhjetë anëtarë të personelit të administratës së Kuvendit të cilët punojnë me shoqërinë civile (përfaqësues të Zyrës së Sekretarit, Departamentit për Media dhe Marrëdhënie me Publikun (DMPR) dhe personelit të komisioneve); dhe 13 përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që marrin pjesë aktive në punën e Kuvendit.

Sikundër është theksuar në raportet e mëparshme, një faktor themelor që ngadalëson përparimin e bashkëpunimit midis Kuvendit dhe shoqërisë civile është mungesa e besimit në mes tyre.⁶ Andaj, ky raport i veçon qartazi informacionet e nxjerra nga intervistat përmes paraqitjes me kursive të deklaratave të cituara. Aty ku të dhënat dytësore nuk kanë qenë në dispozicion, dhe vlerësimi është dashur të mbështetet vetëm në të dhënat nga intervistat, raporti përfshin vetëm pikëpamje që janë përkrahur gjerësisht nga të intervistuarit.

Pjesa 2 paraqet kërkesat dhe praktikave më të mira për parlamentin në fushën e ofrimit të informacionit për publikun, mekanizmave institucionale për marrëdhëniet me shoqërinë civile, dhe praktikave të konsultimit publik. Aty ku udhëzimet dhe dokumentet rreth praktikave më të mira nuk janë lehtësisht të disponueshme, praktikave të avancuara nga rajoni i Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia) dhe nga vendet e tjera evropiane (Austria, Letonia, Sllovenia dhe Mbretëria e Bashkuar) formojnë bazën për standardet e krijuara në këtë kapitull. Pjesa 3 vlerëson punën e Kuvendit kundrejt këtyre standardeve. Ajo merr në konsideratë hapat e fundit që i ka bërë Kuvendi në zgjerimin e portofolit të tij të informimit publik, si dhe në ngritjen e një infrastrukture institucionale për marrëdhëniet me shoqërinë civile. Pjesët 4 dhe 5 paraqesin përkatësisht përfundimet dhe rekomandimet për akterët gjegjësisht, në bazë të gjetjeve të raportit.

⁵ Këto dokumente përfshijnë botimet e Unionit Ndërparlamentar dhe disa dokumente udhëzuese mbi konsultimin publik të botuara nga qeveritë e Austrisë, Kroacisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, si dhe Komisioni Evropian.

⁶ Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, *Dyert, Gjysmë të Hapura apo Gjysmë të Mbyllura*, mars 2010, <http://www.kcsfoundation.org/repository/docs/Studim_mbi_perfshirjen_e_organizatave_te_shoqerise_civile_ne_procesin_legjislativ_shqip.pdf>, (qasur më 19 maj 2012); Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Dokumentim, *Shoqëria civile dhe procesi legjislativ në Kosovë, Studim analitik në fund të mandatit të dytë të Kuvendit të Kosovës*, dhjetor 2007.

2. STANDARDET DHE PRAKTIKAT E MIRA – BASHKËPUNIMI MIDIS PARLAMENTIT DHE SHOQËRISË CIVILE

Qasja e publikut në informacionet e parlamentit

Për pjesëmarrjen e publikut në punën parlamentare nevojitet një bazë e shëndoshë informacionesh. Në radhë të parë, parlamentet duhet të kenë procedura transparente dhe lehtësisht të qasshme, në mënyrë që të procedohen kërkesat për informacion zyrtar të parashtruara nga publiku. Në radhë të dytë, parlamentet duhet të sigurojnë që i gjithë informacioni zyrtar lidhur me punën e tyre të jetë lehtësisht i disponueshëm për publikun. Shumë parlamente, duke përfshirë edhe ata të Shqipërisë, Letonisë, Malit të Zi dhe Serbisë, kanë buletin e tyre ku botohen rregullisht informacionet mbi punën e parlamentit, përfshirë pyetjet parlamentare. Shpeshherë, obligimi për informim publik është i ankoruar në Rregulloren e Punës.⁷

Është me rëndësi që informacioni i publikuar nga parlamenti të përfshijë dokumente të punës, të tilla si projektligjet dhe dokumentet mbështetëse të tyre, transkriptet e seancave plenare dhe të komisioneve, si dhe raportet e komisioneve. Këto dokumente janë subjekt i konsultimeve publike dhe duhet të botohen me kohë. Si rrjedhim, është praktikë e mirë që këto dokumente të punës, bashkë me informacionin përkatës rreth organeve që i prodhojnë ato, oraret e tyre të takimit dhe njoftimet rreth ngjarjeve publikohen në faqen e internetit brenda 2-3 ditëve pas miratimit të tyre.⁸ Publiku dhe OSHC-të duhet të jenë në gjendje që t'i identifikojnë me lehtësi homologët e tyre nëpër komisione dhe të marrin pjesë në punimet e tyre. Praktikë tjetër e zakonshme është përzgjedhja dhe shpallja e një pike kontakti për komisionet parlamentare në faqet e internetit të parlamenteve.⁹

Parakushtet institucionale për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në punën e parlamentit

Nuk ka asnjë model institucional për marrëdhëniet parlament-shoqëri civile. Në disa parlamente, marrëdhëniet me shoqërinë civile janë pjesë e portofolit të marrëdhënieve me publikun. Kështu ndodhë në Shqipëri,¹⁰ Letoni¹¹ dhe Slloveni¹². Në parlamentet e tjera, siç është ai i Malit të Zi¹³, ato janë pjesë e zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm.

⁷ Kështu është në rastin e parlamentit të Kroacisë dhe atij të Shqipërisë, ku kapituj të tërë të Rregullores së tyre të punës u janë dedikuar publicitetit të punës së tyre. Disa parlamente të tjera i referohen publicitetit të punës së parlamentit në kapitujt e rregulloreve të tyre të punës mbi punën plenare apo të komisioneve.

Shih Misionin e OSBE-së në Bosnje dhe Hercegovinë, dokumenti “Përgjigjet në pyetësor” nga takimi rajonal i personelit parlamentar për marrëdhënie me publikun, Sarajevë, 22-23 qershor 2011;

⁸ Shih Unionin Ndërparlamentar, *Udhëzime për faqet e internetit të parlamenteve*, mars 2009,

<<http://www.ipu.org/PDF/publications/ëeb-e.pdf>>, (qasur më 10 tetor 2012).

⁹ *Po aty*, f.18.

¹⁰ *Përgjigjet në pyetësor*, takimi rajonal i personelit parlamentar për marrëdhënie me publikun i organizuar nga OSBE, 22-23 qershor 2011

¹¹ Karina Petersone, *Përfshirja e shoqërisë civile në punën e Kuvendit dhe në bërje të politikave*, prezantim i bërë në “Seminari mbi modelet institucionale për marrëdhëniet shoqëri civile – Kuvend në Kosovë”, 8 qershor 2012, Prishtinë/Priştina, Kosovë.

¹² *Përgjigjet në pyetësor*, shënimi i 10-të i mësipërm.

¹³ Drejtori i Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm, Parlamenti i Malit të Zi, letërkëmbim përmes postës elektronike, 6 nëntor 2012.

Pavarësisht nga mënyra sesi është institucionalizuar kjo marrëdhënie, është me rëndësi që, në praktikë, struktura t'i vë në jetë funksionet e përvijuara më poshtë.

Parlamenti duhet të grumbullojë të dhëna dhe të analizojë pjesëmarrjen e shoqërisë civile në punët e tij. Këto të dhëna mund të shfrytëzohen për të vlerësuar fushëveprimin dhe cilësinë e pjesëmarrjes së shoqërisë civile, për të identifikuar mundësitë dhe kufizimet në qasjen e shoqërisë civile, si dhe për planifikimin e aktiviteteve të komunikimit. Parlamenti duhet të mbajë regjistra zyrtarë të OSHC-ve¹⁴, bashkë me një regjistër të ekspertëve, për t'ua bërë të mundur komisioneve të përpilojnë listë të ngushtë të ekspertizës në dispozicion dhe të komunikojnë me votuesit kyç të përfaqësuar nga shoqëria civile.

Ndërveprimi i parlamentit me shoqërinë civile nuk është më i kufizuar me lehtësimin e pjesëmarrjes së publikut në seancat dëgjimore të komisioneve. Gjithnjë e më shumë, parlamentet po ftojnë pjesëmarrës nga publiku dhe po hartojnë programe shtesë me shoqërinë civile.¹⁵ Parlamenti letonez organizon rregullisht diskutime mbi politikat, seminare dhe konferenca mbi tema të rëndësishme me OSHC-të. Veç këtyre, ai organizon një forum të përvitshëm, në të cilin udhëheqësit e komisioneve marrin pjesë në diskutime rreth politikave sektoriale me shoqërinë civile.¹⁶ Prandaj, parlamentet duhet të sigurojnë burime të mjaftueshme buxhetore dhe njerëzore për të mundur pjesëmarrje dhe aktivitete të përbashkëta të mëtejshme.

Gjithashtu, fushëveprimi i zgjeruar i ndërveprimit midis parlamentit dhe shoqërisë civile kërkon një përkufizim gjithëpërfshirës të kësaj marrëdhënieje, që do të rezultonte nga dialogu mes të dyja palëve. Rezultatet e një dialogu të tillë mund të jenë në formë të ndonjë rezolute apo deklarate parlamentare, sikurse në rastin e Letonisë,¹⁷ apo të një memorandumit të mirëkuptimit, siç ka ndodhur në Mal të Zi.¹⁸ Zakonisht, ky dialog zhvillohet ndërmjet udhëheqësish së parlamentit dhe platformës përfaqësuese të shoqërisë civile. Këto deklarata formale mes parlamentit dhe sektorit të shoqërisë civile mund të përshkruajnë kushtet e bashkëpunimit, dhe mund të mbulojnë edhe çështjet më të gjera përkitazi me zhvillimin e sektorit të shoqërisë civile, si dhe kuadrin ligjor dhe ekonomik në të cilin vepron shoqëria civile.¹⁹

Duke pasur parasysh këtë që u tha më sipër, çdo mekanizëm institucional për marrëdhëniet me shoqërinë civile duhet të ofrojë një kanal që do t'i drejtojë marrëdhëniet me shoqërinë civile, nga administrata (Zyra e Sekretarit, Zyra për marrëdhënie me publikun dhe Zyra për mbështetje deputetëve) deri te udhëheqësia parlamentare. Përveç portofolit të tij të marrëdhënieve me

¹⁴ Unioni Ndërparlamentar, *Parlamenti dhe demokracia në shekullin XXI. Udhëzues për praktika të mira*, 2006, f.86.

¹⁵ *Po aty*, f.80.

¹⁶ Letoni, Departamenti për Marrëdhënie me Publikun i Parlamentit të Letonisë, *Bashkëpunimi i Saeima-s me OJQ-të*, Shënim përmbledhës i ofruar në maj 2012.

¹⁷ Letoni, Parlamenti i Letonisë, *Deklaratë mbi zhvillimin e shoqërisë civile në Letoni dhe bashkëpunimin me organizata joqeveritare*, Rigë, 30 mars 2006, < <http://www.saeima.lv/en/public-participation/the-saeima-and-ngo-forum>>, (qasur më 25 tetor 2012).

¹⁸ Parlamenti i Malit të Zi, *Memorandum i bashkëpunimit midis Parlamentit të Malit të Zi dhe Rrjetit të Organizatave të Shoqërisë Civile për Demokraci dhe Drejtat e Njeriut*, Podgoricë, 2011.

¹⁹ Në deklaratën e tij, parlamenti letonez përkushtohet për të vendosur një “politikë financiare dhe buxhetore të favorshme, që nevojitet për zhvillimin dhe fuqizimin e shoqërisë civile” dhe për të përkrahur zhvillimin e mekanizmave të bashkëpunimit me OSHC-të. Parlamenti i Letonisë, *Deklaratë mbi zhvillimin e shoqërisë civile në Letoni dhe bashkëpunimin me organizata joqeveritare*, shënim i 17-të i mësipërm.

shoqërinë civile në Departamentin për Marrëdhënie me Publikun, Parlamenti i Letonisë ka ngritur një grup punues të përhershëm politik për të bashkërenduar ndërveprimin dhe aktivitetet e parlamentit me shoqërinë civile. Kryetari i Parlamentit, drejtori i Kancelarisë, këshilltari politik dhe ligjor i Kryetarit dhe udhëheqësi i Departamentit për Marrëdhënie me Publikun të Parlamentit të Letonisë që të gjithë marrin pjesë në këtë grup punues.²⁰

Standardet për konsultime publike

Konsultimi publik është proces në të cilin vendimmarrësit kërkojnë qëndrimet e publikut. “Është marrëdhënie dydrejtimshe në të cilën [institucioni publik] përcakton pjesëmarrësit për të marrë reagimet e tyre të shëndosha. [Institucioni publik] siguron që qytetarët të kenë informatat përkatëse paraprakisht.”²¹ Konsultimet me shkrim për një strategji qeveritare, apo një dëgjim parlamentar për një projektligj janë dy shembuj të këtyre konsultimeve.²²

Konsultimi publik ndërmerret nga qeveritë dhe parlamentet, në proceset legjislativ dhe qeveritare të mbikëqyrjes. Disa institucione kanë publikuar tashmë standardet për konsultime publike.²³ Disa parlamente, përfshirë këtu atë austriak dhe skocez, kanë vënë praktikën e quajtur “vëzhgim paralegjislativ”, që është proces konsultimi publik që mbahet para se të hyjë në fuqi projektligji. Në Skoci, ky proces udhëhiqet nga komisionet parlamentare²⁴, derisa në Austri, qeveria i bën këto konsultime.²⁵ Në Kosovë dhe në vendet e Ballkanit Perëndimor, praktika aktuale është që komisionet të mbajnë dëgjime konsultative gjatë procesit legjislativ dhe

²⁰ Parlamenti i Letonisë, *Bashkëpunimi i Saeima-s me OJQ-të*, shënimi i 16-të i mësipërm.

²¹ Dragan Golubović, “Një kornizë mundësuese e pjesëmarrjes së qytetarëve në politikën publike: Një pasqyrë e disa prej çështjeve më madhore (An Enabling Framework for Citizen Participation in Public Policy: An Outline of Some of the Major Issues Involved)”, fusnota si më lart 1, f. 42-43.

²² Konsultimet mund të dallohen nga ndarja e informatave në njëër anë, si dhe pjesëmarrja në tjetrën. Ndarja e informatave është ndërveprim njëdrejtimshe, ku institucionet publike shpërndajnë informata për publikun, por nuk kërkojnë përgjigje. Pjesëmarrja përshkruan një ndërveprim të vazhdueshëm mes vendim-marrësit dhe homologut të publikut, për shembull OJQ-të që shërbejnë në një grup punues qeveritar.

²³ Shembuj janë edhe *Parimet e përgjithshme dhe standardet minimale për konsultim të palëve të interesuara nga Komisioni*, të Komisionit Evropian, <http://ec.europa.eu/transparency/civil_society/consultation_standards/index_en.htm#_Toc46744756>, 11 Dhjetor 2002, (qasur më 4 nëntor 2012); Kodi obligativ i mirësjelljes i Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar: Ekzekutivi me rregullore më të mira, *Kodi i Praktikës së konsultimeve*, korrik 2008, <<http://www.bis.gov.uk/files/file47158.pdf>> (qasur më 3 nëntor 2012); Standardet jo-obligative të Qeverisë Austriake: Kancelaria Federale Austriake, *Standardet e pjesëmarrjes publike, Rekomandime për praktika të mira*, 2011, <http://www.partizipation.at/fileadmin/media_data/Downloads/Standards_OeB/oeb_standards_engl_finale_web.pdf>, (qasur më 20 tetor 2012); Kodi jo-obligativ i Praktikës së Qeverisë Kroate: Qeveria e Kroacisë, *Kodi i praktikës për konsultime me publikun e interesuar në procedurat e miratimit të ligjeve, rregulloreve dhe akteve tjera*, 21 nëntor 2009, <<http://www.uzuvrh.hr/userfiles/file/code%20of%20practice%20on%20consultation-croatia.pdf>>, (qasur më 5 nëntor 2012)

²⁴ Mbretëria e Bashkuar, Parlamenti Skocez, *Udhëzime për Komisionet, Pjesa 2: Fazat e projektligjeve – Rregullat e përgjithshme*, <<http://www.scottish.parliament.uk/parliamentarybusiness/20956.aspx>>, (qasur më 10 nëntor 2012).

²⁵ Në Austri, këto procese, projektligjet apo koncept-dokumentet publikohen në faqen e internetit të qeverisë për një periudhë të caktuar konsultimi, derisa parashtratat e publikut grumbullohen dhe publikohen gjithashtu.

mbikëqyrës, sidomos në fazën kur projektligjet shqyrtohen në hollësi nga komisionet.²⁶

Edhe pse modalitetet e konsultimeve publike dhe çështja e obligimit për t'i kryer varen nga institucioni që kërkon shqyrtimin, si dhe nga faza e procesit të hartimit të politikave, mund të identifikohen disa parime të përbashkëta për konsultimet:

- Konsultimi duhet të përkufizojë qartësisht çështjen e diskutimit. Kjo përfshin informata mbi aspektet që janë të hapura për konsultime, si dhe të cilat tashmë janë finalizuar.²⁷ Përveç këtyre, institucioni konsultues duhet të ofrojë informata të prapavijës që shpjegojnë arsyeshmërinë e konsultimeve²⁸ si dhe qëllimet e vendimit apo politikës.²⁹
- Audiencia e shënjestruar për një konsultim duhet identifikuar si duhet, para procesit, për të siguruar që grupet e ndikuara të mund të ngrenë zërin dhe që të mund të mobilizohet ekspertiza përkatëse.³⁰
- Publiku duhet të ketë qasje në informata në lidhje me procesin para konsultimeve. Informatat duhet të përmbajnë temën e konsultimit, audiencën e shënjestruar/prekur, periudhën e konsultimeve, metodën e konsultimit, si dhe vazhdimësinë e tyre. Këto informata duhen standardizuar për të mundësuar identifikimin e shpejtë të informatave përkatëse.³¹ Informatat nganjëherë i bashkëngjiten ftesës apo shpalljes për konsultime.³²
- Për konsultime duhet ndarë kohë adekuate. Periudha e saktë e konsultimeve mund të dallojë, por zakonisht disa javë ndahen për dorëzim të fakteve me shkrim.³³ Shpesh, një javë njoftim paraprak konsiderohet minimumi për dëgjimet publike të Komisioneve.³⁴
- Procesi i konsultimeve duhet të jetë plotësisht transparent. Shkresat e pranuar duhen publikuar me kohë dhe në mënyrë të qasshme. Është praktikë e zakonshme të publikohen edhe parashtrësit me shkrim edhe transkriptet e dëgjimeve konsultuese në faqen e internetit të komisionit.³⁵ Aty ku konsultimi kufizohet për një audiencë të caktuar të

²⁶ Një shembull që vlen për Kosovën është Doracaku i Dëgjimeve Publike i Kuvendit të Kosovës. NDI (National Democratic Institute) Kosovë dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Doracaku i Dëgjimeve Publike i Kuvendit të Kosovës*, maj 2004, <<http://www.ndi.org/node/13402>>, (qasur më 7 korrik 2012).

²⁷ Kancelaria Federale Austriake, *Standardet e pjesëmarrjes publike, Rekomandime për praktika të mira*, f.13.

²⁸ *Ibid.*, f. 15.

²⁹ Ekzekutivi me rregullore më të mira, *Kodi i Praktikës së konsultimeve*, korrik 2008, f. 9.

³⁰ *Ibid.*, f. 10; Kriteret e Komisionit Evropian për përzgjedhje përfshijnë një baraspeshim përfaqësimi të interesave të kundërt. Përzgjedhja bëhet në bazë të performancës në të kaluarën të palëve të konsultuara gjatë konsultimeve të kaluara. Komisioni Evropian, *Parimet e përgjithshme dhe standardet minimale për konsultim të palëve të interesuara nga Komisioni*, fusnota më lart 23; Qeveria Austriake rekomandon marrjen parasysh të harmonizimit në kategori të grupeve të cënueshme kur zgjedhën palët për konsultim. Kancelaria Federale Austriake, *Standardet e pjesëmarrjes publike, Rekomandime për praktika të mira*, fusnota më lart 27, f. 13.

³¹ Ekzekutivi me rregullore më të mira, *Kodi i Praktikës së konsultimeve*, fusnota më lart 29, f. 10.

³² Kancelaria Federale Austriake, *Standardet e pjesëmarrjes publike, Rekomandime për praktika të mira*, f.14

³³ Në rastin e projektligjeve të Deputetëve të Parlamentit Skocez, që janë projektligje të hartuara nga vetë deputetët, periudha e përcaktuar për konsultime është shtatë javë. Rregullorja e Punës së Parlamentit Skocez, Rregulli 9.14, <<http://www.scottish.parliament.uk/parliamentarybusiness/26514.aspx>>, (qasur më 10 nëntor 2012).

³⁴ Shih, për shembull, Shtetet e Bashkuara, Dhoma e Përfaqësuesve, *Rregullorja e Dhomës së Përfaqësuesve, Kongresi i Njëqindëmbëdhjetë, rregulli XI.3 (A)*,

<<http://www.rules.house.gov/singlepages.aspx?NewsID=160&rsbd=165>> (qasur më 17 janar 2013)

³⁵ Shih, për shembull, Parlamenti Skocez, *Politika për trajtimin e dëshmimeve me shkrim sipas lëndës dhe komisioneve funksionale*, <<http://www.scottish.parliament.uk/Helpandguidance/ParliamentPolicy.pdf>>, (qasur më 10 nëntor 2012).

shënjestruar, kjo duhet bërë e qartë dhe publike.³⁶ Kërkesa e transparencës shpesh zgjerohet për të përfshirë palët e konsultuara, duke i kërkuar atyre të shprehin interesat që ato përfaqësojnë.³⁷

- Edhe informatat kthyese i duhen ofruar organizatave që kanë marrë pjesë në procesin e konsultimeve. Gjitha kontributet e tyre duhet të njihen fillimisht si të tilla.³⁸ Pasi të jenë shqyrtuar gjitha parashtresat, informatat kthyese tjera duhet të përshkruajnë vendimin që është marrë në kuptimin e asaj që është pranuar si parashtresë. Idealisht, këto informata duhen publikuar para se të merret vendimi përfundimtar për politikën e caktuar.³⁹

³⁶ Komisioni Evropian, *Parimet e përgjithshme dhe standardet minimale për konsultim të palëve të interesuara nga Komisioni*, fusnota më lart 23, f. 17.

³⁷ Shih për shembull, Qeveria e Kroacisë, *Kodi i praktikës për konsultime me publikun e interesuar në procedurat e miratimit të ligjeve, rregulloreve dhe akteve tjera*, 21 nëntor 2009, f. 4.

³⁸ Komisioni Evropian, *Parimet e përgjithshme dhe standardet minimale për konsultim të palëve të interesuara nga Komisioni*, fusnota më lart 23.

³⁹ Ekzekutivi me rregullore më të mira, *Kodi i Praktikës së konsultimeve*, fusnota më lart 29, f. 12.

3. KUVENDI I KOSOVËS – ZBATIMI I STANDARDEVE DHE PRAKTIKAVE MË TË MIRA NË BASHKËPUNIMIN MES PARLAMENTIT DHE SHOQËRISË CIVILE

Performanca e Kuvendit në ofrimin e qasjes ndaj punës së tij

Më 2011, Kuvendi ka pranuar 13 kërkesa për qasje në dokumente zyrtare, një numër relativisht modest, pesë nga të cilat nuk ka mundur t'i përgjigjet.⁴⁰ Në fund të vitit 2011, në pajtim me Ligjin për qasje në dokumentet publike, Kuvendi ka emëruar një person kontaktues në Zyrën e Sekretarit për pranimin dhe procedimin e kërkesave për informata zyrtare nga opinioni publik⁴¹ Performanca e Kuvendit në ofrimin e qasjes në informata zyrtare pritet të përmirësohet si rrjedhojë e kësaj. Për hir të transparencës së punës së tij, Kuvendi duhet të bëjë përpjekje që të japë përgjigje në të gjitha kërkesat për qasje në informata zyrtare.

Seancat plenare të Kuvendit dhe takimet e komisioneve janë publike, si dhe mund të përcillen duke u regjistruar paraprakisht.⁴² Projektligjet që i dorëzohen Kuvendit, rendet e ditës dhe transkriptet e seancave plenare, procesverbalet e takimeve të komisioneve dhe regjistrat elektronikë të votimit publikohen në faqen e Kuvendit.⁴³ Përveç këtyre, Kuvendi nxjerr një buletin tremujor, ku botohen pyetjet e Deputetëve për qeverinë që nuk kanë marrë përgjigje.⁴⁴ Buletini gjithashtu botohet në faqen e internetit të Kuvendit.⁴⁵ Kuvendi gjithashtu mban një kalendar takimesh në faqen e tij të internetit, ku informohet publiku për seancat plenare, takimet e komisioneve dhe takimet e Kryesisë së Kuvendit. Përveç këtyre, Kuvendi nxjerr rregullisht deklarata shtypi për seancat plenare dhe takimet e komisioneve. Këto informata të Kuvendit, nëse zbatohen në mënyrë konsistente, mundësojnë pjesëmarrje të mjaftueshme publike. Vënia si prioritet e faqes së Kuvendit në internet si mjet i informimit publik është në përputhje me praktikat më të mira.⁴⁶

Megjithatë, ende mbesin disa mangësi të rëndësishme. Dokumentacioni i obligueshëm përcjellës⁴⁷ i projektligjeve, memorandumit shpjegues që ofron qëllimin e ligjit, duke përfshirë edhe përputhshmërinë e tij me legjislacionin ekzistues, si dhe vlerësimi i ndikimit buxhetor të tij, nuk publikohen në faqen e Kuvendit. Këto dokumente i duhen vënë në dispozicion publikut, pasi që ofrojnë vështrim më të afërt të arsyeshmërisë dhe ndikimit të secilit projektligj të propozuar.

Informatat kritike për punën e komisioneve ose nuk janë në dispozicion, ose nuk publikohen me kohë. Aktualisht, raportet e komisioneve nuk publikohen fare. Procesverbalet e takimeve të

⁴⁰ Zyra e Kryeministrit të Kosovës, *Raport gjithëpërfshirës 2011 – për Institucionet Publike, realizimi i të drejtës për qasje në dokumente publike*, Prishtina, 2012, p. 8, <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Comprehensive_Report_Anglisht.pdf>, (qasur më 3 nëntor 2012).

⁴¹ Ligji nr. 03/L – 215 për qasje në dokumente publike, 7 tetor 2010, neni 5

⁴² Kuvendi i Kosovës, Rregullorja e Punës së Kuvendit të Kosovës, 29 prill 2010, nenet 43 dhe 65.

⁴³ *Po aty*, nenet 43, 51 dhe 53.

⁴⁴ *Po aty*, nenet 45 dhe 46.

⁴⁵ Shih faqen e internetit të Kuvendit të Kosovës, <<http://assembly-kosova.org/?cid=2,163>>, (qasur më 10 nëntor 2012).

⁴⁶ Shih Unioni Ndërparlamentar (IPU), *Udhëzime për faqet e internetit të parlamenteve, fushnota më lart 8*.

⁴⁷ Kuvendi i Kosovës, Rregullorja e Punës së Kuvendit të Kosovës, 29 prill 2010, neni 54

komisioneve shpesh publikohen me vonesë, kur informatat që përmbahen aty nuk kanë më kuptim për OSHC-të që duan të marrin pjesë: *“Shumica e informatave që ofrohen nga Kuvendi nuk janë të rëndësishme për punën tonë. Për shembull, projektligjet në diskutim publikohen në faqen e Kuvendit, vetëm për versionet që dorëzohen nga qeveria, derisa ndryshimet brenda komisioneve nuk reflektohen e as publikohen. Ngjashëm, procesverbalet e takimeve të komisioneve publikohen me vonesë, shpesh pasi ajo çështje nuk ka më interes, ose nuk publikohen fare.”*⁴⁸

Në fund të vitit 2012, Kuvendi miratoi Strategjinë e tij të parë të Informimit dhe Marrëdhënieve me Publikun.⁴⁹ Strategjia përqendrohet tek marrëdhëniet me publikun, marrëdhëniet me shoqërinë civile, marrëdhëniet me elektoratin, si dhe informatat që prodhohen nga Kuvendi për informim publik. Me periudhë vlefshmërie prej 2012-2015, strategjia e Kuvendit i trajton disa mangësi që përshkruhen si më lart. Ajo e përkushton Kuvendin që të publikojë informatat në mënyrë të vazhdueshme dhe me kohë për punën e komisioneve në faqen e internetit të Kuvendit.⁵⁰ Këto veprime duhen vënë si prioritet në zbatimin e strategjisë.

Struktura institucionale për bashkëpunimin me shoqërinë civile në Kuvend

Qysh prej fundit të vitit 2012, është krijuar një rregullim i ri institucional për marrëdhëniet me shoqërinë civile, duke zëvendësuar dhe përmirësuar përgjegjësitë e kaluara të Departamentit për Media dhe Marrëdhënie Publike (DMMP).⁵¹

Kuvendi ka ndërtuar një bazë të dhënash për shoqërinë civile në faqen e vet të internetit, e cila do të shërbejë si regjistër i organizatave të shoqërisë civile në pajtim me praktikën më të mira ndërkombëtare.⁵² Baza e të dhënave është e hapur për regjistrimin e gjitha organizatave të shoqërisë civile dhe e qasshme për Deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe palët e interesuara. Ajo do të shërbejë si burim për identifikimin e palëve përkatëse gjatë konsultimeve. Që prej ftesës publike për regjistrim, mbi 60 organizata janë regjistruar.⁵³ Këto organizata të regjistruara kanë ofruar informata për interesat e tyre në fusha, fushat e tyre të ekspertizës dhe aktivitetet e kaluara, si dhe janë ftuar të shënojnë komisionet që duan t'i përcjellin. Baza e të dhënave do t'i mundësojë personelit të komisioneve të identifikojnë organizatat në bazë të ekspertizës dhe përvojës së tyre.

Pozita e Zyrtarit të Lartë për Marrëdhënie me Shoqërinë Civile tanimë është ngarkuar me administrimin e bazës së të dhënave për shoqërinë civile, si dhe me zhvillimin dhe përgatitjen e aktiviteteve të përbashkëta të Kuvendit dhe udhëheqësisë së tij me shoqërinë civile. Kjo do të

⁴⁸ Intervistë me Taulant Hoxhën, Menaxher Programi, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, maj 2012.

⁴⁹ Kuvendi i Kosovës, *Strategjia e Informimit dhe Marrëdhënieve me Publikun e Kuvendit të Kosovës*, 25 tetor 2012, <http://assembly-kosova.org/common/docs/2012_10_25_Strategy.pdf>, (qasur më 2 tetor 2012).

⁵⁰ *Po aty.*, f. 2-3.

⁵¹ DMMP-ja më herët ka qenë përgjegjëse për “informimin e shoqërisë civile dhe qytetarëve për aktivitetet e Kuvendit dhe organeve të tij”. Megjithatë, me këtë mekanizëm të mëhershëm, ka pasur pak aktivitete përafri me publikun. Kuvendi i Kosovës, *Rregullorja për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Kuvendit të Kosovës*, Prishtinë/Priština, tetor 2010.

⁵² Baza e të dhënave është në dispozicion tek <<http://assembly-kosova.org/?cid=2,1007>>, (qasur më 10 nëntor 2012).

⁵³ Pesëdhjetë organizata ishin të regjistruara deri në nëntor 2012.

adresoje një brengë të identifikuar gjatë intervistave për këtë raport.

“Kuvendi duhet ta caktojë një person apo zyrtar të veçantë i cili do të komunikojë vetëm me OSHC-të. Nëse të gjithë merren me këtë askush nuk është përgjegjës.”⁵⁴

Zyrtari i lartë për marrëdhënie me shoqërinë civile duhet të përdorë bazën e të dhënave të shoqërisë civile për të gjurmuar pjesëmarrjen e OSHC-ve në punën e Kuvendit dhe për të identifikuar audiencën për aktivitetet e përbashkëta dhe komunikimin e synuar. Funksionaliteti dhe përdorimi i bazës së të dhënave duhet të vlerësohet rregullisht dhe zhvillohet edhe më tutje. Ajo duhet të përdoret për të monitoruar dhe raportuar për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në punën e komisioneve, dhe praktikatat e mira të konsultimit publik duhet të promovohen përbrenda Kuvendit. Është gjithashtu e rëndësishme që ky zyrtar të bashkërendohet për së afërmi me personelin në DMMP për të mundësuar aktivitete më të shumta të kontaktit me publikun dhe për tu siguruar që puna e DMMP-së është në pajtim me objektivat e Strategjisë së Kuvendit për informim dhe marrëdhënie me publikun.

Përtej këtyre kërkesave për bashkëpunim rutinor, rregullimi ri do të duhej ta plotësonte nevojën për ndërveprim ndërmjet shoqërisë civile dhe udhëheqësisë politike të Kuvendit. Kuvendi duhet ta përkufizojë marrëdhënien e tij përballë sektorit të shoqërisë civile në mënyrë më të gjerë, dhe të angazhohet me shoqërinë civile në nivel të kryesisë së Kuvendit. Siç e ka theksuar një anëtar i kryesisë së Kuvendit: *“Deputetët, personeli i administratës dhe shoqëria civile duhet ta hartojnë një strategji për bashkëpunim institucional ndërmjet të dy [palëve]. Kjo gjithashtu mundëson [...] rregullimin e statusit të OSHC-ve [në Kuvend]”⁵⁵*

Kryesia e kuvendit duhet të angazhohet me shoqërinë civile për të përmirësuar rrjedhën e informatave të rëndësishme, përfshirë informatat për programin e punës së Kuvendit: *“Kuvendi duhet të ketë (dy) takime të rregullta me OSHC-të për paraqitjen e strategjisë legjislative. Takimi i parë është për vendosjen e konsultimeve në programin e punës dhe takimi i dytë është për të parë se sa nga to janë realizuar.”⁵⁶*

Strategjia për informim dhe marrëdhënie me publikun propozon krijimin e një grupi punues të përbërë nga Kuvendi i Kosovës dhe shoqëria civile, i cili do të ketë një anëtar të caktuar të kryesisë së kuvendit dhe do të “takohet rregullisht me përfaqësuesit e shoqërisë civile për të negociuar një rezolutë parlamentare, për parimet e bashkëpunimit – duke i marr para sysh dispozitat e strategjisë së bashkëpunimit ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile.”⁵⁷ Mbështetja e këtij grupi punues është përgjegjësi e bartësit të pozitës së zyrtarit të lartë për marrëdhënie me shoqërinë civile. Kjo zgjidhje është modeluar me kujdes në bazë të praktikave më të mira që zbatohen në Letoni dhe Mal të Zi, që janë përvijuar në kapitullin e mëparshëm. Pasi të jetë arritur pajtimi për dokumentin kornizë që i përfshinë parimet e bashkëpunimit dhe pasi të jetë arritur pajtimi për rregullimin e sektorit të shoqërisë civile, grupi punues do të duhet që së bashku ta mbikëqyrë implementimin e atyre standardeve dhe aktiviteteve, në bazë të të dhënave të mbledhura nga zyrtari i

⁵⁴ Intervistë me Ismet Mahmutin, Zyrtar për Media, Departamenti për media dhe marrëdhënie me publikun, Kuvendi i Kosovës, maj 2012.

⁵⁵ Intervistë me Glauk Konjufcën, anëtar i Kryesisë, Kuvendi i Kosovës, maj 2012.

⁵⁶ Intervistë me Zenun Pajazitin, kryesues i Komisionit për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri, Kuvendi i Kosovës, maj 2012.

⁵⁷ Kuvendi i Kosovës, *Strategjia për informim dhe marrëdhënie me publikun e Kuvendit të Kosovës*, supra shënimi 49, f. 6.

lartë për marrëdhënie me shoqërinë civile.

Në fund, është e rëndësishme që këto struktura dhe aktivitete të reja të financohen në mënyrë adekuate nga buxheti i Kuvendit të Kosovës për vitin 2013 dhe 2014. Aktivitetet në terren të zyrtarit të lartë për marrëdhënie me shoqërinë civile dhe mbështetja e grupit punues Kuvend-shoqëri civile në veçanti, do të kërkojë ndarjen e një buxheti funksional modest për t'i mbuluar shpenzimet për vizitat komunikuese, takimet, tryezat e rumbullakëta dhe aktivitetet e ngritjes së vetëdijes.

Cilësia e praktikave të Kuvendit në konsultimet publike

Pjesëmarrja e shoqërisë civile në punën e komisioneve të Kuvendit rregullohet me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Neni 65 (4) saktëson që “komisionet mund të ftojnë përfaqësues të institucioneve dhe të shoqërisë civile për të marr pjesë në takimet e tyre me qëllim të paraqitjes së dëshmive apo për krijimin dhe paraqitjen e dokumenteve të rëndësishme.”⁵⁸ Përveç kësaj, komisionet mund të mbajnë edhe takime publike “me ekspertë, organizata publike, përfaqësues të grupeve të interesit dhe me persona tjerë”, ku komisionet angazhohen në diskutim të thellë me këta persona.⁵⁹ Andaj, dëgjimet publike sigurojnë mundësi për organizatat e shoqërisë civile për të paraqitur dhe argumentuar pikëpamjet e tyre. Komisionet gjithashtu mund të angazhojnë ekspert për t'i mbështetur ato në punën e tyre legjislativë dhe të mbikëqyrjes.⁶⁰ Këto dispozita procedurale janë të krahasueshme nga natyra dhe fushëveprimi me ato të shumë parlamenteve në Ballkanin perëndimor dhe Evropë dhe janë adekuate për lehtësimin e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në punën e Kuvendit.⁶¹

Ashtu si në shumicën e parlamenteve, Kuvendi, në bazë të Rregullores së tij të punës, nuk është i detyruar që të bëjë konsultime publike. Doracaku i publikuar së voni për funksionin e mbikëqyrjes të komisioneve parlamentare, megjithatë përvijon standarde bazë për konsultim. Ai saktëson që dëgjimet publike lajmërohen së paku një javë para mbajtjes së tyre për t'iu mundësuar pjesëmarrësve që t'i përgatisin dëshmitë e tyre, ai gjithashtu thekson që dëgjimet lajmërohen në faqet e internetit të Kuvendit dhe shpallen në mediat e lajmeve, dhe që i gjithë dëgjimi transkriptohet.⁶²

Në seancat publike, komisioni fton ekspertë dhe pjesëtarë të publikut që të komentojnë për një çështje para komisionit. Zakonisht, të ftuarve iu ndahen ndërmjet 5 deri 10 minuta për paraqitjen e rastit të tyre, pas së cilave anëtarët e komisionit parashtrajnë pyetje.

⁵⁸ Rregullorja e punës e Kuvendit të Kosovës, 29 prill 2010, neni 65 (4).

⁵⁹ *Po aty.*, Neni 66.

⁶⁰ *Po aty.*, Neni 65 (3).

⁶¹ Për shembull, janë të krahasueshme me Rregulloren e Punës të Parlamentit të Malit të Zi, i cili gjithashtu e lejon angazhimin e ekspertëve dhe të ashtuquajturve dëgjime konsultative. Mal I Zi, Parlamenti i Malit të Zi, Rregullorja e Punës e Parlamentit të Malit të Zi, neni 73, <http://www.skupstina.me/cms/site_data/poslovnik/Poslovnik%20Skupstine%20Crne%20Gore.pdf>, (e qasur më 12 nëntor 2012).

⁶² Kuvendi i Kosovës, *Doracaku për funksionin mbikëqyrës të komisioneve parlamentare*, Prishtinë/Pristina, qershor 2012, f. 17-18.

Dëgjimet publike zakonisht thirren nga komisioni funksional⁶³ në procesin e rishikimit legjislativ apo procesin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve nga qeveria e Kosovës. Fushëveprimi i konsultimit në procesin e rishikimit legjislativ është i tërë teksti i projektligjit (por jo edhe dokumentacioni i tij mbështetës, që aktualisht nuk është i publikuar). Në procesin e mbikëqyrjes, dëgjimet mund të jenë më specifike, duke i mbuluar disa aspekte të zbatimit që janë identifikuar si problematike. Në vitin 2011, Kuvendi i ka miratuar 65 ligje, e ka mbikëqyrrur zbatimin e 11 ligjeve dhe i ka shqyrtuar 80 raporte të auditimit dhe raporte të institucioneve të pavarura⁶⁴. Ka mbajtur 68 dëgjime publike.⁶⁵ Mesatarisht, komisionet konsultohen me publikun në masë të madhe gjatë punës së tyre; gati gjysma e të gjitha aktiviteteve të komisioneve kanë pasur elemente të konsultimeve publike. Ky është shembull i shkëlqyeshëm i praktikës së mirë të konsultimit publik që Kuvendi duhet të orvatet ta vazhdoj edhe në të ardhmen.

Ndryshe nga konsultimet në internet në procesin e “kontrollimit para-legjislativ” që praktikohet në disa parlamente Evropiane, dëgjimet publike parlamentare janë veprime konsultimi që janë të kufizuara për sa i përket kohës që i ndahet dhe audiencës që konsultohet. Gjatë një dëgjimi dy deri tri orësh, komisioni mund ta dëgjojë vetëm një numër të vogël të personave. Prandaj, identifikimi i palëve të duhura për t’u konsultuar është thelbësor. Duhet të përzgjidhen ata persona apo grupe që preken nga projektligji apo ata që kanë ekspertizë sektorale për ta vërtetuar cilësinë e tij. Identifikimi i audiencës së synuar është treguar si sfida për praktikën aktuale të konsultimit që përdoret nga Kuvendi. Deri vonë, kuvendi nuk ka pasur regjistër të organizatave të shoqërisë civile, gjë që i ka detyruar komisionet që t’i ftojnë ato organizata që rregullisht marrin pjesë në punën e tyre. Komisionet duhet ta shfrytëzojnë bazën e të dhënave për shoqërinë civile të Kuvendit kur të identifikojnë palët për konsultim. Koordinatorët e komisioneve duhet të rishikojnë rregullisht informatat e reja në bazën e të dhënave dhe t’i ftojnë organizatat e shoqërisë civile që e kanë shprehur interesin për komisionin e fushës së tyre dhe të fusin më shumë informata për aktivitetet e tyre në bazën e të dhënave.

Aktualisht, komisionet nuk e respektojnë rregullisht orarin për dëgjime publike të sugjeruar në Doracakun e Kuvendit për funksionin e mbikëqyrjes së komisioneve parlamentare. Dëgjimet publike shpesh lajmërohen vetëm disa ditë para mbajtjes së tyre, në faqen e internetit të Kuvendit. Kjo e kufizon kohën për identifikimin e palëve të duhura për konsultim, dhe aftësinë e atyre palëve për ta përgatitur dëshminë dhe shkresat e tyre. Prandaj, komisionet duhet t’i lajmërojnë dëgjimet e tyre së paku një javë para mbajtjes së ngjarjes.⁶⁶

Informatat për temën, audiencën e synuar, periudhën e konsultimit, mënyrën e konsultimit dhe vazhdimësinë e dëgjimit janë të kufizuara për publikun. Aktualisht kuvendi nuk ka formular për lajmërim, ftesa dhe komunikimin e mëtutjeshëm pas dëgjimit publik. Në praktikë, dëgjimet publike lajmërohen në kalendarin e faqes së internetit të Kuvendit. Lajmërimi përmban vetëm

⁶³ Në procesin legjislativ, komisioni funksional është përgjegjës për rishikimin e projektligjit, nen për nen, për mbledhjen dhe shqyrtimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të mundshme të projektligjit, dhe për raportimin në seancën plenare.

⁶⁴ Shifrat janë mbledhur nga raportet e rregullta të monitorimit që është bërë nga OSBE-ja. Raportet e monitorimit të Kuvendit të Kosovës mund të gjenden në: <<http://www.osce.org/kosovo/66128>>, (e qasur më 10 nëntor 2012).

⁶⁵ *Ibid.*

⁶⁶ Instituti Nacional Demokratik i Kosovës & Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Doracak i dëgjimeve publike në Kuvendin e Kosovës*, f. 10.

informata themelore, përfshirë komisionin përgjegjës, datën dhe vendin e dëgjimit, si dhe “rendin e ditës” për dëgjimin, që zakonisht është i kufizuar në një rresht.⁶⁷

Kuvendi duhet të zhvillojë formular për dokumentet sqaruese që i shoqërojnë lajmërimet dhe ftesat për dëgjime publike. Dokumentet sqaruese duhet të përmbajnë informata përmbledhëse për temën e dëgjimit, për arsyetimin dhe lëndën e konsultimit, për palët e synuara të konsultimit, për kontributet e kërkuara me shkrim, dhe për çfarëdo vazhdimi të planifikuar të aktivitetit. Për t’u siguruar që shkresat e pranuar janë të dobishme, që komisionet mund të lëshojnë një formular standard për shkresat që do të shpërndahej së bashku me lajmërimin për dëgjimin publik.⁶⁸

Mungesa e informacionit gjithashtu e dëmton transparencën e konsultimeve të komisioneve. Ndonëse ekzistojnë listat e pjesëmarrësve dhe transkriptet e dëgjimeve publike, ato dokumente nuk sigurohen për pjesëmarrësit, e as nuk publikohen vazhdimisht në faqen e internetit të Kuvendit. Është me rëndësi të ceket që shkresat nga palët e konsultuara as nuk mblidhen e as nuk publikohen.

Siç është cekur më lart, Kuvendi është zotuar përmes Strategjisë së tij për informim dhe marrëdhënie me publikun që të publikojë listat e pjesëmarrësve dhe transkriptet e dëgjimeve publike në faqet e internetit të komisioneve. Kuvendi gjithashtu duhet të publikojë shkresat e pranuar nga ekspertët, shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare. Publikimi i shkresave të tilla do ta rriste llogaridhënien e komisioneve ndaj publikut: *“Ne duhet të mendojmë që ta kemi një vend të veçantë në faqen e internetit të Kuvendit për publikimin e propozimeve të bëra nga OSHC-të për ndryshimin dhe plotësimin e dispozitave të ndryshme të ligjeve.”*⁶⁹ Një mundësi tjetër në një periudhë afatshkurtër do të ishte që shkresat nga dëgjimet publike t’i bashkëngjiten raporteve të komisioneve. Raportet e komisioneve pastaj do të duhej të publikoheshin në faqen e internetit të Kuvendit në pajtim me praktikën më të mira ndërkombëtare.⁷⁰

Konsultimi publik është proces i komunikimit me dy kahje. Mirëpo, komisionet nuk japin vazhdimisht informata kthyesë për palët e konsultuara, të cilat duhet të tregojnë nëse shkresat janë marrë para sysh nga Komisioni. Koordinatorët e komisioneve duhet ta gjurmojnë se a janë marrë para sysh shkresat dhe të ofrojnë informata kthyesë për palët e konsultuara me kërkesë të tyre. Praktika e konsultimit nga komisionet e Kuvendit duhet të zhvillohet dhe kodifikohet edhe më tej, në pajtim me avancimet e fundit të qeverisë.⁷¹ Kodifikimi mund të merr formën e parimeve të konsultimeve të përfshira në rregullat e Kuvendit. Ndonëse nuk është zgjidhje gjithëpërfshirëse për Kuvendin, Komisionet e interesuara do të mund të parashihnin kritere më strikte në rregulloret e tyre të punës.⁷²

⁶⁷ Kalendar i Kuvendit mund të gjendet në <<http://assembly-kosova.org/?cid=2,159>>, (e qasur më 12 nëntor 2012).

⁶⁸ Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Libër referimi për organizatat e shoqërisë civile – Pjesëmarrja në mbikëqyrjen legislative dhe proceset buxhetore të Kuvendit*, Nëntor 2011, <<http://www.osce.org/kosovo/89170>>, (e qasur më 29 maj 2012).

⁶⁹ Intervistë me Sherif Konjufcën, Drejtor, Departamenti për media dhe marrëdhënie me media, Kuvendi i Kosovës, maj 2012.

⁷⁰ Bashkimi ndër-parlamentar, *Udhëzimet për faqet e internetit të Parlamenteve*, supra shënimi 8, f. 23.

⁷¹ Projekt propozimet për të cilat kërkohet koncept dokumenti publikohen nga ministria përkatëse për atë nismë ligjore dhe komentet nga OSHC-të që preken nga ato nisma merren në mënyrë aktive, shih nenin 32, Rregullorja nr. 03/2011, Rregullorja e Punës e Qeverisë së Kosovës, 7 shtator 2011.

⁷² Shih nenin 62, Rregullorja e Punës e Kuvendit të Kosovës.

Është me rëndësi që të vërehen mangësitë e mundshme në performancën e shoqërisë civile për sa i përket pjesëmarrjes dhe kontributeve të dorëzuara në dëgjimet publike të Kuvendit:

“Në dëgjimet publike, shumë OJQ nuk bëjnë asnjë koment apo nuk japin asnjë kontribut. Ato thjeshtë marrin pjesë nëpër takime të komisioneve në mënyrë pasive.”⁷³ “Roli i shoqërisë civile duhet të orientohet në ofrimin e alternativave, propozimin e zgjidhjeve dhe në kalimin nga kjo fazë aktuale në bërjen e shumë deklaratave kritike”.⁷⁴ “Kur disa OSHC të caktuara kanë sugjerime apo vërejtje për ligjet që miratohen në Kuvend, ato vijnë tek ne në minutën e fundit apo edhe shumë më vonë, kur puna në ligji nga komisionet funksionale tashmë është përfunduar [...] Shpesh ndodhë që OSHQ-të i drejtohen komisioneve funksionale me qëllim të shprehjes së pikëpamjeve dhe sugjerimeve të tyre.”⁷⁵

Fatkeqësisht, për shkak të mungesës së dokumentacionit për dëgjimet publike, këto konstatime nuk mund të vërtetohen përfundimisht.⁷⁶ Vetëm monitorimi gjithëpërfshirës i pjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe publikimi i kontributit të ofruar për Komisionet mundësojnë Kuvendin që në mënyrë sistematike të identifikojë mungesat e kontributeve të shoqërisë civile të ofruara lidhur me punën e Komisioneve.

⁷³ Intervistë me Ismet Mahmutin, Zyrtar për Media, Departamenti për media dhe marrëdhënie me publikun, Kuvendi i Kosovës, maj 2012.

⁷⁴ Intervistë me Kushtrim Kaloshin, Drejtor ekzekutiv, Qendra burimore për avokim dhe trajnim, maj 2012.

⁷⁵ Intervistë me Goran Marinković, kryesues, Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthimeve, Kuvendi i Kosovës, maj 2012.

⁷⁶ OSBE-ja nuk ishte në gjendje të sigurojë transkriptet e plota të dëgjimeve publike dhe listën e pjesëmarrësve nga vitit 2011 për këtë raport.

4. PËRFUNDIME

Kuvendi ka shënuar përparim të konsiderueshëm në rritjen e bashkëpunimit me shoqërinë civile. Vazhdimi i këtij përparimi varet nga zhvillimet e mëtejme të rregullimeve institucionale si dhe zbatimit pasues të zotimeve lidhur me informimin publik. Për të dyja, Kryesia e Kuvendit duhet të kushtojë vëmendje në ndarjen e buxhetit dhe burimeve njerëzore për këto aktivitete.

Fakti që dokumentet e punës së Kuvendit shpeshherë nuk janë në dispozicion publik pengon cilësinë e pjesëmarrjes. Dokumentacionet mbështetëse të hartimit të ligjeve, raportet e komisioneve, transkriptet e dëgjimeve publike si dhe kontributet e shoqërisë civile në dëgjime publike duhet të publikohen rregullisht. Në zbatimin e Strategjisë për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun Kuvendi duhet t'i kushtojë rëndësi të lartë publikimit të dokumenteve të punës në faqe e tij të internetit. Publikimi i këtyre dokumenteve do të rriste ngarkesën e punës së stafit mbështetës të komisioneve dhe stafit të DMMP. Kuvendi do të duhet të qartësojë përgjegjësitë dhe të krijojë ndarje të drejtë të barrës së përgjegjësisë. Veç kësaj, Kuvendi do të duhet të punësojë staf mbështetës shtesë në komisione, për të përballuar kërkesat në rritje dhe ngarkesën e punës së komisioneve.

Më 2012, Kuvendi ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt përmirësimit të infrastrukturës për bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile. Është e rëndësishme që bartësi i pozitës së Zyrtarit të Lartë për Marrëdhënie me Shoqërinë Civile të zhvillojë më tej funksionalitetin e bazës së të dhënave të shoqërisë civile dhe ta shfrytëzojë ata si mjet për monitorim. Zyrtari do të ketë nevojë për trajnime adekuate dhe resurse buxhetore për realizimin e këtyre detyrave dhe për të komunikuar me sukses me shoqërinë civile. Duke pasur parasysh përvojën e kufizuar të Kuvendit në marrëdhëniet me shoqërinë civile, ai mund të llogarisë në mbështetjen e donatorëve për t'i zhvilluar kapacitetet e zyrtarit të ri.

Kryesia e Kuvendit nuk ka pasur ndërveprime të rregullta shoqërinë civile në të kaluarën. Duke pasur parasysh kompleksitetin më të madh të marrëdhënieve me shoqërinë civile dhe kërkesave më të shumta për bashkëpunim nga ta, Kuvendi duhet ta përkufizojë këtë marrëdhënie me shoqërinë civile në nivelin më të lartë. Krijimi i një grupi punues të nivelit të lartë me pjesëmarrjen e shoqërisë civile, siç parashihet në Strategjinë e Kuvendit për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, është zgjidhje adekuate.

Komisionet parlamentare konsultohen me publikun gjerësisht në punën e tyre legjislative dhe të mbikëqyrjes. Mesatarisht, ata mbajnë dëgjime publike për pothuajse gjysmën e të gjitha çështjeve që i kanë në shqyrtim. Shoqëria civile merr pjesë rregullisht në këto dëgjime. Komisionet duhet t'i planifikojnë me kujdes dëgjimet publike dhe të krijojnë pako standarde informuese dhe formularë për kontributet me shkrim për palët e konsultuara. Megjithatë, ngarkesa aktuale e punës dhe numri i stafit mbështetës për komisione mund të mos lejojë informata shumë të detajuara kthyesë. Publikimi i kontributeve me shkrim në faqet e internetit të komisioneve do të ishte hapi i parë.

Në fund, informatat e grumbulluara përmes intervistave nënvizojnë mangësi në performancën e OSHC-ve në dëgjime publike. Megjithatë, për shkak të mungesës së të dhënave të monitorimit lidhur me pjesëmarrjen e OSHC-ve, natyra dhe madhësia e këtyre mangësive nuk është e qartë.

Përgjigja lidhur me këtë çështje nga ana e Kuvendit dhe donatorëve të interesuar do të jetë e mundur vetëm pasi të jetë futur një sistem gjithëpërfshirës i monitorimit.

5. REKOMANDIMET PËR KUVENDIN:

Ofrimi i qasjes në informatat që kanë të bëjnë me punën e Kuvendit:

- Kuvendi duhet të publikojë të gjitha informatat e obligueshme mbështetëse të projektligjeve krahas tekstit të ligjeve në faqen e internetit të Kuvendit, në pajtim me afatet kohore të cekura në Rregulloren e Punës të Kuvendit dhe rregulloret tjera përkatëse;
- Kuvendi duhet të publikojë informatat përkatëse që kanë të bëjnë me punën e komisioneve në faqet e internetit të komisioneve brenda 2 deri 3 ditëve pas takimit përkatëse të komisionit apo dëgjimit publik. Në veçanti, të publikohen të gjitha raportet e komisioneve, procesverbalet e takimeve të komisioneve, transkriptet e dëgjimeve të komisioneve, si dhe listat e pjesëmarrësve.
- Kuvendi duhet të bëjë përpjekje që në mënyre të vazhdueshme t'i përgjigjet të gjitha kërkesave për qasje në dokumente zyrtare, përmes përmirësimit të dërgimit të përgjigjeve nga ana e personit kontaktues në Kuvend

Formati institucional për bashkëpunimin me shoqërinë civile në Kuvend:

- Kuvendi duhet t'i nxisë OSHC-të të regjistrohen në bazën e të dhënave të shoqërisë civile të Kuvendit, duke ofruar informata gjithëpërfshirëse lidhur me interesat e tyre, si dhe dokumentacionin lidhur me aktivitetet e mëparshme;
- Zyrtari i Lartë për Marrëdhënie më Shoqërinë Civile duhet vazhdimisht të vlerësojë dhe përmirësojë funksionalitetin e bazës së të dhënave të shoqërisë civile;
- Zyrtari i Lartë për Marrëdhënie më Shoqërinë Civile duhet krijojë një sistem monitorimi për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në punën e komisioneve parlamentare. Baza e të dhënave të shoqërisë civile mund të jetë bazë për një sistem të tillë;
- Zyrtari i Lartë për Marrëdhënie më Shoqërinë Civile duhet të planifikojë dhe lehtësojë aktivitete të komunikimit, duke përfshirë seminare dhe punëtori lidhur me tema përkatëse, duke shfrytëzuar informatat e ruajtura në bazën e të dhënave të shoqërisë civile. Duhet të ndahet një buxhet modest operacional për aktivitetet e komunikimit me shoqërinë civile nga buxheti i Kuvendit të Kosovës;
- Zyrtari i Lartë për Marrëdhënie më Shoqërinë Civile dhe DMMP duhet të kenë bashkëpunim të ngushtë për aktivitetet e komunikimit me shoqërinë civile;
- Kryesia e Kuvendit duhet të iniciojë themelimin e Grupit Punues Kuvend-Shoqëri Civile i cili do të realizojë një dialog për përmirësim të parimeve të bashkëpunimit ndërmjet Kuvendit dhe shoqërisë civile;

- Grupi Punues Kuvend-Shoqëri Civile duhet t'i analizojë rastet e praktikave të mira në bashkëpunimin parlamentar me shoqërinë civile, siç është korniza në Parlamentin Letonez dhe praktikat më të mira rajonale në Malin e Zi;
- Grupi Punues Kuvend-Shoqëri Civile duhet të negociojë një përkufizim të marrëdhënies ndërmjet Kuvendit dhe shoqërisë civile e cila është e pajtueshme për të dyja palët, si dhe të hartojë një draft dokument për parimet e bashkëpunimit;
- Kryesia e Kuvendit duhet të merr parasysh shtimin e angazhimit të saj me shoqërinë civile. Një opsion mund të jetë mbajtja e takimeve të rregullta (gjashtëmujore) informuese lidhur me agjendën legjislative dhe programin e punës së Kuvendit për organizatat e shoqërisë civile dhe mediat.

Praktikat e Kuvendit për konsultimet publike:

- Komisionet duhet të shfrytëzojnë bazën e të dhënave të shoqërisë civile në Kuvend për identifikimin e palëve për konsultime;
- Komisionet duhet t'i shpallin dëgjimet publike së paku një javë para mbajtjes për t'iu mundësuar palëve që marrin pjesë në konsultime që të bëjnë përgatitje adekuate të deklaratave të tyre dhe të dorëzojnë komente me shkrim;
- Kuvendi duhet të nxjerrë mostër shabllon për dokumentet shpjeguese të cilat i shoqërojnë shpalljet dhe ftesat për dëgjime publike. Dokumentet shpjeguese duhet të përfshijnë informata përmbledhëse lidhur me temën e përgjithshme të dëgjimit, arsyetimin dhe çështjen specifike të konsultimit, palët e caktuara në konsultime, kontributet e kërkuara me shkrim, si dhe aktivitetet e planifikuara përcjellëse;
- Kuvendi duhet të nxjerrë formularë standardë për dorëzimin e komenteve të cilët do të shpërndahen bashkë shpalljen e dëgjimit publik;
- Koordinatorët e komisioneve duhet të përcjellin se në çfarë mase janë marrë parasysh kontributet e dorëzuara, sa herë që kjo të jetë e mundur, të ofrojnë informata kthyesë për palët e konsultuara për atë se sa janë marrë parasysh komentet e tyre;
- Komisionet duhet të publikojnë listën e pjesëmarrësve, transkriptet e dëgjimeve publike dhe kontributet me shkrim të pranuar nga ekspertët, shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare në faqet e tyre të internetit brenda 2-3 ditëve pas dëgjimit;
- Komisionet duhet të marrin parasysh miratimin e Rregullores së Punës për qëllime të tyre me rregulla më të rrepta për konsultime publike, duke përfshirë kërkesat minimale për konsultime;
- Kuvendi duhet të vlerësojë përshtatshmërinë e niveleve të stafit për mbështetje të komisioneve. Niveli adekuat i stafit të komisioneve duhet të jetë prioritet.

SHTOJCA I: Pyetësor

1. Përgjithësisht, si do ta vlerësonit bashkëpunimin ndërmjet Kuvendit dhe Organizatave të Shoqërisë Civile?
2. Raporti i fundit i Progresit i BE-së ka nënvizuar disa aspekte për marrëdhënien ndërmjet Kuvendit dhe Shoqërisë Civile. Raporti thekson se “Dëgjimet publike vazhdojnë të jenë sporadike dhe shoqëria civile nuk është e përfshirë në mënyre efektive në debate të Kuvendit (faqe 6 e raportit)”. Cili është mendimi juaj lidhur me këtë?
3. Për më tepër, Raporti i Progresit shton se “nuk ka platformë të institucionalizuar që do të mundësonte dialog të rregullt ndërmjet Kuvendit dhe organizatave të shoqërisë civile” Cili është mendimi juaj lidhur me këtë?
4. Raporti i Progresit thekson se “Opinionet publike ka kuptim të ulët lidhur me rolin e shoqërisë civile” Si e komentoni këtë? Pse?
5. Veç kësaj, raporti sugjeron se “Qeveria, Kuvendi dhe komunat duhet të bashkëpunojnë më mirë me shoqërinë civile”. A pajtoheni me këtë? Sipas mendimit tuaj, çfarë lloj bashkëpunimin duhet të krijohet ndërmjet Kuvendit dhe shoqërisë civile?
6. Çfarë roli luajnë aktualisht OSHC-të në punën me Kuvendin? Çfarë roli duhet të luajnë?
7. Cila është përvoja juaj personale në punën me OSHC-të/Administratën/Deputetët?
8. Me sa OSHC/pjesëtarë të stafit të Kuvendit/Deputetë keni qenë drejtpërdrejt apo tërthorazi të përfshirë në punën tuaj ditore në Kuvend?
9. Sa relevante dhe të dobishme ishin informatat që i keni pranuar nga OSHC-të/stafi i Kuvendit/Deputetët në punën tuaj (qofshin ato dëgjime publike, grupe punuese, debate publike, etj.)
10. A mund t’i cekni disa nga OSHC-të me të cilat keni punuar?
11. A keni kontakte të drejtpërdrejta (email apo telefon) me përfaqësues të OSHC-ve/Deputetë të Kuvendit? Sa shpesh komunikoni me ta?
12. Sa shpesh jeni kontaktuar nga OSHC-të/Deputetë të Kuvendit lidhur me përfshirjen në punën e Kuvendit?
13. A duhet Kuvendi të bëjë diçka tjetër për të përfshirë OSHC-të edhe më shumë në punën e Kuvendit?
14. A dëshironi të shtoni diçka tjetër për bashkëpunimin ndërmjet OSHC-ve dhe Kuvendit?

SHTOJCA II: Lista e të intervistuarve

Nr.	Emri	Mbiemri	Funksioni
Deputetë			
1.	Ahmet	Isufi	Kryesues i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Kuvendi i Kosovës
2.	Ganimete	Musliu	Kryesuese e Grupit të Deputetëve të Rinj të Kuvendit të Kosovës
3.	Teuta	Sahatqija	Kryesuese e Grupit të Grave Deputete, Kuvendi i Kosovës
4.	Glauk	Konjufca	Anëtar i Kryesisë, Kuvendi i Kosovës
5.	Enis	Kervan	Anëtar i Kryesisë, Kuvendi i Kosovës
6.	Zenun	Pajaziti	Kryesues i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Kuvendi i Kosovës
7.	Goran	Marinković	Kryesues i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, Kuvendi i Kosovës
8.	Susan	Novobërdali	Kryesuese e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, Kuvendi i Kosovës
Stafi i Administratës së Kuvendit			
9.	Ismet	Krasniqi	Sekretar, Kuvendi i Kosovës
10.	Sherif	Konjufca	Udhëheqës i Zyrës për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, Kuvendi i Kosovës
11.	Ismet	Mahmuti	Zyrtar për Media, Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, Kuvendi i Kosovës
12.	Xheladin	Hoxha	Udhëheqës i Divizionit për Mbështetje për Komisionet Parlamentare, Kuvendi i Kosovës,
13.	Idriz	Tahiri	Koordinator i Komisionit, Komisioni për Legjislacion, Kuvendi i Kosovës
14.	Nur	Çeku	Koordinator i Komisionit, Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Kuvendi i Kosovës
15.	Rrahim	Demaj	Koordinator i Komisionit, Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, Kuvendi i Kosovës
16.	Lule	Ymeri	Koordinator i Komisionit, Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Kuvendi i Kosovës
17.	Armend	Ademaj	Koordinator i Komisionit, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Kuvendi i Kosovës
18.	Safet	Beqiri	Zyrtar i Lartë, Komisioni për Integritet Evropian, Kuvendi i Kosovës
Organizata të Shoqërisë Civile			
19.	Valdete	Idrizi	Drejtoreshë, CiviKos
20.	Taulant	Hoxha	Menaxher Programi, Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KCSF)

21.	Driton	Selmanaj	Menaxher Programi, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)
22.	Valmir	Ismaili	Menaxher Programi, Demokracia për Zhvillim (D4D)
23.	Kushtrim	Kaloshi	Drejtor Ekzekutiv, Qendra e Trajnimit dhe Burimeve për Avokim (ATRC)
24.	Petrit	Zogaj	Drejtor Ekzekutiv, “Lëvizja FOL”
25.	Hajrulla	Çeku	Drejtor, “Ec ma Ndryshe”
26.	Artan	Venhari	Zyrtar i Lartë për Hulumtim, Instituti Kosovar për Politika dhe Hulumtim dhe Zhvillim (KIPRED)
27.	Albert	Krasniqi	Hulumtues, Instituti Kosovar për Politika dhe Hulumtim dhe Zhvillim (KIPRED)
28.	Luljeta	Demolli	Menaxher Programi/Hulumtues, Qendra Kosovare për Studime Gjinore (KCGS)
29.	Flutura	Kusari	Koordinatorë Projekti dhe Këshilltare Ligjore, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN)
30.	Albulena	Sadiku	Koordinatorë Projekti, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN)
31.	Raba	Gjoshi	Drejtoreshë Ekzekutive, Nisma Rinore për të Drejta të Njeriut (YIHR)